

Metodologjia për përcaktimin e kriterëve për ndarjen e përkrahjes financiare shoqatave dhe fondacioneve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës

Me këtë dokument përcaktohen dokumentet, mënyra dhe procedurat për ndarjen e mjeteve nga Buxheti i Komunës së Kërçovës të destinuar për përkrahjen e projekteve të shoqatave dhe fondacioneve.

PRANUES TË MJETEVE

Mjetet buxhetore janë të destinuar për shoqatat dhe fondacionet të cilat janë të regjistruara sipas Ligjit për shoqata dhe fondacione në Republikën e Maqedonisë së Veriut ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 52/2010, 135/2011 dhe 55/2016), me seli në Komunën e Kërçovës, pa dallim nëse janë të sapoformuara apo me përvojë.

IDENTIFIKIMI I SFERAVE PRIORITARE PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE

Mjetet e planifikuara nga Buxheti i komunës prej linjës buxhetore 463 Transfere tek OJQ janë të dedikuara për përkrahjen e propozimprojekteve të shoqatave dhe fondacioneve të cilat kontribuojnë për arritjen e qëllimeve të përcaktuara dhe të vërtetuara në dokumentet strategjike, planet dhe programet e komunës, të cilat, posaçërisht kanë të bëjnë me kulturën dhe manifestimet, të rinjtë, si dhe krijimtarinë dhe trashëgiminë kulturore.

THIRRJE PUBLIKE

Shpërndarja e mjeteve për projekte shoqatave dhe fondacioneve bëhet në bazë të thirrjes publike (në tekstet e mëposhtme: thirrje), e shpallur prej Komisionit për thirrje publike për ndarjen e mjeteve shoqatave dhe fondacioneve, në ueb faqen e komunës dhe mjetet e informimit publik.

Vlera e mjeteve për financimin apo bashkëfinancimin e projektpropozimeve përcaktohet çdo vit me vendim për buxhetin komunal.

Mund të publikohen disa thirrje gjatë vitit, sipas dispozicionit të mjeteve financiare të Komunës së Kërçovës.

Thirrja i përmban së paku elementet në vazhdim:

- Sferat dhe qëllimet prioritare
- Kriteret bazë organizative
- Kriteret e posaçme të projekteve
- Kornizë kohore për realizimin e projekteve
- Gjithsej mjetet e parapara/në dispozicion
- Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim
- Afati për dorëzimin e paraqitjeve i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 20 ditë prej ditës së publikimit të thirrjes
- Adresa në të cilën duhet të dorëzohen dokumentet

Fletparaqitjet me dokumentacion të pa plotësuar ose pas kalimit të afatit të paraparë nuk do të procedohen. Materialet e bashkangjitura nuk kthehen.

Shoqatat dhe fondacionet në thirrje mund të paraqiten edhe në partneritet me aktivitete projektsh të përbashkëta.

Së bashku me thirrjen, komuna e Kërçovës në ueb faqen e vete publikon **formular për paraqitje të projektpropozimeve** duke bashkangjitur edhe **formularin e buxhetit**.

Të gjitha dokumentet të cilat komuna i publikon, do të publikohen në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

Përdorimi i vetëm një gjuhe nuk do të ndikon në procesin e sjelljes së vendimit.

Formular për paraqitje të projekt-propozimit
Formulari për buxhet i bashkangjitur

PROCEDURAT GJATË SJELLJES SË VENDIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE PËR FINACIMIN E PROJEKTEVE TË SHOQATAVE DHE FONDACIONEVE

KOMISIONI PËR NDARJEN E MJETEVE

Vlerësimi i parë themelor për zgjedhjen e projektpropozimeve të cilat do të financohen prej mjeteve buxhetore kryhet prej Komisionit për thirrje publike (në tekstin e mëposhtëm Komisioni) i formuar prej Kryetarit të Komunës.

Komisioni i ka kompetencat për sa vijon:

1. I kontrollon paraqitjet për propozimprojektet e shoqatave dhe fondacioneve;
2. Zgjedh propozimprojekte të cilat janë propozuar për financim abo bashkëfinancim dhe
3. Jep propozim deri te Kryetari i komunës për ndarjen e mjeteve.

Në rast të konfliktit të interesave, në rastin kur anëtari i Komisionit është edhe aplikant, ose është i punësuar në institucion, ose në ndonjë mënyrë tjetër është i lidhur me projektin, si anëtar i komisionit është i detyruar ti informojë anëtarët e tjerë të komisionit dhe duhet të përjashtohet prej votimit për atë projektpropozim.

Komuna i publikon rezultatet e thirrjes, si edhe raportin e mjeteve të ndara me shumën e ndarë dhe emrin e shoqatës dhe fondacionit, për vitin kalendarik, në ueb faqen e komunës, si dhe e dorëzon deri te Këshilli i komunës.

VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE

Komisioni vendos për ndarjen e mjeteve shoqatave dhe fondacioneve, e paraprirë prej evalumit të projektit sipas kriteriumeve të vendosura me sistem të pikëve prej 1 deri 5 për secilin kriter veçmas, (kriteret e vendosura janë me koeficient të ndryshëm kuptimor).

Në procesin e miratimit të projekteve në drejtim të sygjërimeve, ri spjegimit të gjërave të caktuara të theksuara në projektin aplikues, këshillime, aplikuesit do të thirren që të prezantojnë para komisionit. Komisioni i thërret aplikuesit me tema të ngjajshme për t'i shtyrë që të bashkëpunojnë në iniciativa të përbashkëta.

Do të vendoset për dy grupe të propozim-projekteve edhe atë, projekte të cilat do të realizohen në partneritet, e ata do të bodohen sipas kriteriumit 1-7, kurse projektet që kryhen vetëm prej një realizuesi do të bodohen me kriteriumin 1-6.

Në rast kur dy ose më shumë projekte fitojnë numër të njëjtë pikësh, kurse mjetet nuk janë të mjaftueshme, mjetet do t'i ndahen propozim-projektit, i cili sipas mendimit të shumicës së komisionit, kontribuon më shumë në plotësimin e nevojave më priotare të qytetarëve.

Mjete për financimin e propozim-projekteve fitojnë aq aplikues të shoqatave dhe fondacioneve sa lejon gjithsejt buxheti për thirrjen për projekte të komunës.

Vlerësimi i cilësisë të propozim-projekteve duke përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të kryhet në përputhshmëri me kriteriumet e vërtetuara dhe të dhëna në tabelën e evalumin, e cila është e bashkangjitur në këtë dokument.

Tabela për vlerësim, e bashkangjitur.

SISTEMI I VLERËSIMIT

Anëtarët e komisionit kryejnë vlerësimin për secilin kriter veçmas. Rezultati përfundimtar i pikëve pasqyron numrin e përgjithshëm të pikëve për çdo propozim-projekt veçmas.

Anëtarët e Komisionit plotësojnë dhe nënshkruajnë tabelën e përbashkët kumulative të vlerësimit për secilin propozim-projekt. Rangimi i propozim-projekteve kryhet në atë mënyrë që projekti i parë i plasuar është ai që ka më shumë pikë, pastaj vijon ai me numër më të vogël, e ashtu deri në atë me numër më të vogël të pikëve.

NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES

Pas vendimit për ndarjen e mjeteve dhe pas publikimit, Komuna e Kërçovës dhe shoqata, fondacioni e cila ka fituar mjete financiare, në afat prej 15 ditësh prej datës së vendimit, nënshkruajnë marrëveshje me të cilën rregullohen të drejtat dhe obligimet e përbashkëta.

RAPORT PËR REALIZIMIN E PROJEKTIT

Shoqatat dhe fondacionet të cilat kanë fituar mjete financiare për projektin e dorëzuar, sjellin raport narrativ dhe financiar për realizimin e projektit tek komisioni, 30 ditë pas realizimit të projektit ose deri në fund të vitit për të cilin i janë miratuar mjetet.

Formularët për raportin narrativ dhe financiar do tu dorëzohen shoqatave dhe fondacioneve të përkrahura në formë elektronike pas nënshkrimit të dokumentit.

Formularë për raport narrativ dhe financiar të bashkangjitura.

MONITORIMI I REALIZIMIT TË PROJEKTIT

Me qëllim të informimit të publikut më të gjërë me projektet e realizuara, nga ana e Komisionit dhe Këshillit të Komunës, në mënyrë adekuate do të pasqyrohen aktivitetet që i realizojnë shoqatat dhe fondacionet, projektet e të cilave do të mbështeten. Monitorimi përfshin vizita në terren në aktivitete të lajmëruara që më parë në kornizat e projektit.

Komisioni realizon procedura për vlerësimin e shfrytëzimit të mjeteve financiare dhe për rezultatet e arritura nga aktivitetet e mbështetura të bazuara në raportet e dorëzuara nga shoqatat dhe fondacionet. Komisioni dorëzon raport me shkrim për shfrytëzimin e mjeteve të ndara dhe rezultatet e arritura prej projekteve të mbështetura nga Komuna e Kërçovës deri te Këshilli i Komunës së Kërçovës. Përderisa gjatë realizimit të projektit vërtetohet se mjetet e ndara nuk shfrytëzohen në përputhshmëri me marrëveshjen për realizimin e projektit të miratuar, do të kërkohet që të kthehen mjetet e pranuar.